



**KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT
SH.A. - PEJË**



Zyret qendrore

Rr. Lekë Dukagjini Nr. 156 30000 Pejë
Telefoni: 039 / 432 355
www.hidrodrini.com

Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve i KRU "HIDRODRINI" SH.A., Pejë, i emëruar sipas Vendimit Nr.24/216 dt. 14.08.2024 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në kompetencat sipas dispozitave ligjore të Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike, nr.03/L-087, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr.04/L-111 dhe numër 05/L-009, nenin 21.1 që përcakton kompetencat ekskluzive të Bordit të Drejtorëve, bazuar në nenin 14 të Statutit të Kompanisë Rajonale të Ujësjiellësit "HIDRODRINI" SH.A. - Pejë, dhe në nenin 19.2 të Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrje Publike, Bordi i Drejtorëve në mbledhjen e mbajtur me datën 22.10.2024 në mënyrë unanime nxjerrë këtë:

V E N D I M

1. Shkarkohet nga detyra e Sekretares të KRU Hidrodrini, znj.Kreshnike Dreshaj me efekt të menjëhershëm;

Arsyetim

Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve, ka konstatuar në vazhdimësi parregullësi në punën e Sekretares dhe rrjedhimisht ka humbur besueshmëria ndaj të njejtës dhe ushtrimit të detyrave sipas rolit që i është besuar.

Sekretarja ka vendosur në lajthitje Bordin e Përkohshëm të Drejtorëve me rastin e mosdhënies së informacionit mbi numrin e saktë të aplikantëve për pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv, duke dëshmuar se e njejtja nuk është në nivelin e detyrës dhe përgjegjësive të saj.

Për më tepër, Sekretarja në vazhdimësi i ka prezantuar Bordit të Përkohshëm të Drejtorëve vendime me preambulë të pasaktë, duke u thirrur në referenca të gabuara ligjore, për të krijuar pastaj hapësirë për interpretime të dyanshme të vendimeve, ashtuqë vendimet të mos kenë efekt juridik.

Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve ka konkluduar se puna e Sekretares pa ndërprerë është shoqëruar me lëshime substanciale dhe paaftësi profesionale, të cilat pengojnë punën e Bordit dhe efektivitetin e tij.

Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit të tij, data 22.10.2024.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur ka të drejtë e ankesës në Gjykatën Themelore në Pejë, në afat prej tetë (8) ditësh.

Qendresa KUKAJ

Kryesuese e Bordit të Përkohshëm të Drejtorëve

- Vendimi i dërgohet:
- 1x Bordit të drejtorëve,
 - 1x ME-NJPMNP-Prishtinë,
 - 1x Arkivit të NP,
 - 1x palës.

